

**ALVIN SARAÇI**

Instituti i Historisë/ Akademia e Shkencave e Shqipërisë

saracialvin@hotmail.com

<https://doi.org/10.61773/6j79fd64>

**MBI ORIGJINËN SHQIPTARE  
TË PAPËS KLEMENTI XI - ALBANI****Abstrakt:**

*Artikulli trajton origjinën shqiptare të Papës Gianfrancesco Albani - Klementi XI (1700-1721), i cili i interesuar për prejardhjen e tij ngarkoi në vitin 1720 jezuitin Filippo Riceputi, i cili së bashku me arbëreshin nga Zadari (Zara) Paçifik Bicin të ndërmerrnin një udhëtim në Shqipëri dhe të mblidhnin relacione që hidhnin dritë mbi familjen Albani, e cila në fillim quhej Laçi. Fokusi i kërkimeve ishin zonat nga e kishte prejardhjen familja: Laçi i Kurbinit, Laçi i Zadrimës dhe Laçi i Krasniqes në Tropojë e në Kosovë. Sipas relacioneve, familja duhet ta ketë origjinën nga Laçi i Kurbinit, por ka gjasa që të jetë edhe nga zona e afërt e Laçit të Zadrimës. Prania e mbiemrit Laçi në Kosovë hedh dhe hipotezën që familja të jetë zhvendosur nga verilindja drejt Arbërisë Qendrore dhe më pas të ketë emigruar në Itali.*

**Fjalë kyçe:**

Origjinë, shqiptare, Gianfrancesco Albani Klementi XI, Laç, Kosovë.

Papa Gianfrancesco Albani Klementi XI (1700-1721)<sup>1</sup> vinte nga një familje shqiptare, e cila mbajti në Itali një mbiemër që dëshmonte

<sup>1</sup> Simon Reboulet, *Histoire de Clement XI* (Avignon, Gianfrancesco Albani Clemente XI (1649-1721), vol. I-II (Avignon: 1752); Stefano Andreata, "Papa Clemente XI", *Dizionario Bibliografico degli Italiani*, vol. XXVI (Roma: Istituto dell'Enciclopedia Italiana Treccani, 1982), 302-320; Eqrem Zenelaj, *Gjenealogjia e familjes shqiptare Albani nga Urbino dhe Bergamo e Italisë – Papës Clementi XI – Albani* (Prishtinë: Faik Konica, 2009). Gianfrancesco Albani lindi në Urbino nga një familje me origjinë shqiptare, e cila mund të ketë pasur lidhje me familjen Albani të Bergamos dhe një degëzim të saj në Venecia. Ajo mbështetej nga familja Barberini. Kur ishte i ri gjatë studimit në bibliotekën e Grotaferratës, e cila i përkiste Urdrhit bazilian katolik të rritit bizantin që përbëhej kryesisht nga arbëreshë, gjeti një dorëshkrim në greqisht për

prejardhjen nga Shqipëria. Origjina shqiptare e ka shtyrë atë që të mbante lidhjet me vendin e të parëve. Klementi XI ishte i interesuar për gjithçka që i përkiste historisë antike dhe moderne të Shqipërisë. Në vitin 1695, kur ishte kardinal i lindi ideja për përgatitjen e një vepre enciklopedike mbi Ilirinë, të quajtur: *Illyricum Sacrum*, pasi iu dha rasti të njihej me jezuitin Filippo Riceputi, i cili mblidhte inkunabula që i përkisnin kësaj zone që shtrihej nga Danubi dhe përfshinte edhe Maqedoninë dhe Epirin. Kështu, kardinal Albani e mbështeti financiarisht Riceputin për dy vjet ndërsa ndiqte seminarin për të realizuar këtë projekt që përfshinte historinë kishtarë dhe civile të Ilirisë në udhëtimet e tij në Dalmaci, Kroaci dhe Austri.<sup>2</sup> Këtë e pohon edhe Stefan Paulovich Lucich, në të dhënat biografike të Riceputit në hyrje të një vepre të shkruar prej tij, ku pikërisht flitet për dokumente që dëshmojnë origjinën e Papës Albani.<sup>3</sup>

“Prandaj, Papa Klementi XI nga familja princërore Albani, e cila sipas dokumenteve të pamohueshme rezulton ta ketë origjinën e lakmueshme nga Shqipëria ilire, iu përkushtua ai i pari, para se të

---

menologjinë e Bazil Porfirogjenit. U diplomua më 1668 në jurisprudencë dhe vazhdoi studimet për teologji. Në vitin 1690 u ngrit në rangun e kardinalit dhe u zgjodh Papë në vitin 1700. Ishte periudha kur fronti i Spanjës u bë shkak për një luftë europiane ndërmjet monarkisë absolute të Luigjit XIV të Francës e habsburgëve të Austrisë dhe iu desh të përballej me ta kur zbritën edhe në shtetin e kishës në Itali, pavarësisht qëndrimit neutral deri në vendosjen e paqes me Traktatet e Utrehtit (1713) dhe Rastatit. Mori pjesë në polemikën me jansenistët francezë kryesisht me Quesnel-in dhe Fenelon-in përkrah jezuitëve. U mor me bamirësi dhe ndihmoi banorët e Romës gjatë katastrofave natyrore. Për sa i përket kontributit të tij për Shqipërinë, duhet pasur parasysh mbledhja e Kuvendit të Arbrit (1703) nën drejtimin e argjipeshkvit të Tivarit, Vinçenc Zmajeviqit, mbështetja e projektit të enciklopedisë *Illyricum Sacrum*, ku vëllimi 7 dhe 8 i saj i referohet Shqipërisë dhe trojeve si dhe i Gramatikës së parë Shqipe të hartuar nga Francesco Maria da Lecce. Papa Albani dhe nipi i tij kardinal Alessandro Albani koleksiononin vepra arti, libra e dorëshkrime, të cilat u shpërndanë në muze dhe biblioteka të ndryshme.

<sup>2</sup> Silvano Cavazza, “Daniele Farlati”, *Dizionario bibliografico degli italiani*, vol. 45 (Roma: Istituto dell’Enciclopedia Italiana “Giovanni Treccani”, 1995), 47-48.

<sup>3</sup> Stefan Paulovich Lucich, “Cenni intorno all’autore. Filippo Riceputi” në *Memorie di cose dalmatiche nella storia della vita di San Giovanni Orsini vescovo di Trau scritta da padre Riceputi* (Zara: Tipografia Demarchi-Rougier, 1864), 7. “Imperocche’ Clemente XI P. M. Della principesca prosapia degli Albani, la quale per indubbi documenti consta l’avita origine trarre dall’Albania illirica, erasi dato lui primo, innanzi che salisse al pontificato in sul comporre codesta istoria: non appena gli fu noto il divisamento di Filippo”.

ngjitej në Selinë e Shejtë përgatitjes së kësaj historie: sapo mori vesh qëllimin e Riceputit”.

Për këtë ndërmarrje, ai vazhdonte të kishte përkrahjen e Gianfrancesco Albanit, i cili pati rolin e mentorit. Kështu, gjatë viteve 1707-1709, ai i vazhdoi kërkimet për mbledhjen e materialeve ndërkohë që jepte mësim në Goricia, Rjeka (Fiume) dhe Trieste.<sup>4</sup> Më pas, Riceputi u vendos në Venecia në vitin 1708. Pikërisht në këtë periudhë, ai dhe disa misionarë të tjerë ndërmorën një udhëtim përgjatë brigjeve të Dalmacisë, i cili dha rezultatet e tij, sepse ata kaluan nga një qytet në tjetrin në kërkim të materialeve për enciklopedinë. Në vitet 1709-1715, Propaganda Fide e dërgoi atë në Dalmaci me kërkesën e kryeipeshkvit të Splitit Stjepan Kozma që ta kishte më të lehtë nxjerrjen e dorëshkrimeve.<sup>5</sup>

Në vitin 1719, Papa Albani i hapi atij dyert e arkivave për hulumtime dhe ata u takuan gjatë qëndrimit në Romë. Riceputi i dorëzoi për botim prospektin ose skicën e enciklopedisë 8 vëllimëshe dhe *correctiones* me titull: *Prospectus Illyrici Sacri*, që e kishte nisur në vitin 1718 ku shpjegonte se si do ta realizonte këtë vepër, që u botua në vitin 1720, u ribotua më 1738 dhe me disa ndryshime në vitin 1742.<sup>6</sup> Ndërkohë Papa i dhuroi atij një koleksion me dorëshkrime për Ilirinë, që do të ishin të vlefshme për historinë e saj.

Numrin më të madh të dokumenteve, Riceputi e grumbulloi pikërisht pas audiencës që pati me Papën Klementi XI, më 30 prill 1720, i cili i dha një rekomandim origjinal që të vazhdonte kërkimet përtej detit edhe në Shqipëri.<sup>7</sup> Me këtë rast, njëkohësisht me enciklopedinë ai do të hulumtonte për paraardhësit dhe origjinën shqiptare të Papës.<sup>8</sup>

Ai e ngarkoi Filippo Riceputin me mbledhjen e relacioneve të misionarëve shqiptarë dhe të huaj në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni dhe

<sup>4</sup> Miroslav Vanino, “Philipp Riceputi S.I. Begründer des “Illyricum sacrum””, *Archivum historicum Societatis Iesu*, I (Roma: 1932), 208.

<sup>5</sup> Musa Ahmeti, Etleva Lala, *Illyricum Sacrum, botime dhe dokumenta* (Tiranë: Ombra GVG, 2007), 48.

<sup>6</sup> Filippo Riceputi, *Prospectus Illyrici Sacri cujus historiam describendam, typisque mandandam suscipit P. Philippus Riceputi Societatis Jesu sacerdos* (Patavii: Excudebat Josephus Cominus, 1720); Ahmeti & Lala, *Illyricum Sacrum*, 14-15, 79, 96.

<sup>7</sup> *Po aty*, 80-82.

<sup>8</sup> Vanino, “Philipp Riceputi”, 211.

konsullit venecian të Durrësit disa prej të cilëve ishin njoftuar që t'i dërgonin të dhëna lidhur me familjen e tij, si dhe objekte që i përkisnin asaj. Në fakt, në një dorëshkrim të autorit me të njëjtin titull: *Prospectus Illirici Sacri*, përmbledhen disa relacione nga Shqipëria të cilat japin një përshkrim të origjinës së familjes Albani.<sup>9</sup> Ky dorëshkrim i ka rënë në dorë edhe Zef (Giuseppe) Valentinit, i cili i ka kushtuar dhe një shkrim të tijin.<sup>10</sup> Si rezultat i kërkimeve në vitet e kaluara, duke u mbështetur mbi këto relacione kam përgatitur dy artikuj që trajtojnë origjinën shqiptare të Klementit XI dhe të familjes Albani.<sup>11</sup>

Në këtë udhëtim që do të zgjaste për rreth një vit Riceputi u shoqërua nga Paçifik Bici (Pacifico Bizza), shqiptar nga Zadari (Zara),<sup>12</sup> një nga bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë për grumbullimin dhe studimin e dorëshkrimeve nga viti 1718, i cili më pas u ngjit në selinë ipeshkvnore të Zarës më 1738 dhe të Splitit më 1746. Ata përshkuan të gjithë Dalmacinë e u ndalën në Shqipëri në qytetet e Shkodrës, Lezhës dhe Durrësit.<sup>13</sup> Kur arritën në Kotorr mundën të gjenin materiale që u përkisnin zonave të cilat ishin në Perandorinë Osmane dhe u erdhi një letër nga Papa Klementi XI me 15 pika që të hidhnin dritë mbi gjenezën e familjes Albani.<sup>14</sup>

Kjo përkon me atë që shkruhet në dorëshkrim, ku thuhet se Papa i kishte dërguar Riceputit 14 pika si promemorie që t'i kishte parasysh për kërkimet e tij sipas një skeme të përcaktuar dhe pas mbledhjes së relacioneve të përgatiste një relacion mbi origjinën e familjes:<sup>15</sup>

1. “Nëse familja Laçi gjendej akoma në Shqipëri dhe në cilën zonë?

2. Nëse familja ishte fisnike ose jo?

<sup>9</sup> Biblioteca del Museo Correr (më tej: BMC), manoscritto (më tej: ms.), codice (më tej: cod.), Cicogna (më tej: cic.) 3222/V; Riceputi, *Prospectus Illirici Sacri*.

<sup>10</sup> Giuseppe Valentini, “Albani-Lazzi”, në *Leka*, viti XV, nr. 2 (1943), 139-143.

<sup>11</sup> Alvin Saraçi, “Le origini albanesi di un Papa: Clemente XI Albani”, *Notiziario dell'Associazione Nobiliare Regionale Veneta*, Nuova Serie, anno II, 2 (2010), 133-144; *po ai*, “Relazioni di missionari cattolici sull'origine albanese del Papa Clemente XI Albani”, *Notiziario dell'associazione nobiliare regionale veneta*, 4 (2012), 109-118.

<sup>12</sup> Simon Ljubich, *Dizionario bibliografico degli uomini illustri della Dalmazia* (Vienna: Lechner, Zadar: Battara e Abelich, 1856), 93.

<sup>13</sup> Ahmeti & Lala, *Illyricum Sacrum*, 81.

<sup>14</sup> Vanino, “Philipp Riceputi”, 212; Valentini, “Albani-Lazzi”, 189.

<sup>15</sup> BMC, ms. cod. cic. 3222/V; Riceputi, *Prospectus Illirici Sacri*.

3. Nëse pema gjenealogjike e familjes kishte edhe degë të tjera?
4. Cilat prej tyre ishin fisnike dhe cilat jo?
5. Nëse pasardhësit dhe degët e tjera ishin katolikë apo u përkisnin besimeve të tjera fetare?
6. Nëse ka akoma pasardhës të familjes në zonat afër Shqipërisë dhe cilat janë ato?
7. Nis me kujtimin e Gjergjit dhe Filipit, djemtë e Mikelit?
8. Në cilin qytet të Shqipërisë banonte Mikeli?
9. Cilit prijës ia lanë dy vëllezërit principatën e tyre (proniën) dhe kur arritën në Itali?
10. Nëse nga Shqipëria morën me vete edhe gratë dhe cilave familje u përkisnin ato?
11. Nëse morën me vete edhe fëmijët dhe të afërmit dhe kush ishin ata?
12. Çfarë profesioni kishin dy vëllezërit dhe nëse ata përcillnin njerëz apo mesazhe diplomatike?
13. Nëse vijnë nga Laçi e nëse vazhdon edhe më pas linja e trashëgimtarëve dhe nëse ata janë farefis me vëllezërit?
14. Pëlqehet që ato [kërkimet] të bëhen në këtë provincë dhe të jenë më të sakta në këtë fushë nëse do të ketë të tilla”.

Gjithashtu, atyre u erdhi në ndihmë në Tivar argjipeshkvi Egidio Quinto d'Armento (d'Armeno), i cili ishte informuar më parë. Ai kishte pasur rol kryesor në mbajtjen dhe përkthimin në shqip të vendimeve të Kuvendit të Arbrit dhe kishte përcjellë Vinçenc Zmajeviqin (Visko Zmajević), i cili nga viti 1713 ishte zhvendosur në Zadar (Zarë) dhe i kishte mbështetur gjatë udhëtimit.<sup>16</sup>

Madje, gjatë një udhëtimi tjetër, Paçifik Bici zbuloi në Zadar edhe relacionin e Marin Bicit të vitit 1612, asokohe argjipeshkëv i Tivarit, me të cilin kishte lidhje farefisnore.<sup>17</sup>

<sup>16</sup> *Po aty*; Alvin Saraçi, “Feja dhe Atdheu në Kuvendin e Arbrit: Roli i Papë Klementit XI, Propagandës Fide dhe Vinçenc Zmajeviqit”, *Studime historike*, nr. 2 (2022): 53-72.

<sup>17</sup> Vanino, “Philipp Riceputi”, 217. Relacioni u botua sipas Vaninos në Daniele Farlati, Jacopo Coleti, *Illyrici Sacri*, vol. VII (Venezia: Sebastiano Coleti, 1817), 109-123; “Relatione della visita fatta da me Marino Bizzi, Arcivescovo d'Antivari, nelle parti della Turchia, Antivari, Albania et Serbia. Alla Santità di Nostro Signore Papa Paolo Quinto”, 1610, në *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të Mesme në shek. XVII, Burime e materiale* (1634-1650), përkth. dhe përgat. për botim Injac Zamputi,

Lidhur me origjinën shqiptare të familjes Albani, Riceputi duhej të mblidhte dorëshkrime dhe objekte që i përkisnin asaj si dhe relacionet e disa misionarëve katolikë në Shqipëri dhe Kosovë, konsullit venecian të Durrësit dhe dëshmitë e banorëve.

Në fillim, familja Albani e kishte mbiemrin Laçi (Lazzi), të cilin pas vendosjes në Itali e ndryshoi në Albanese. Sipas Valentinit, mbiemri i mëparshëm Laxi i familjes Albani përkon me mbiemrin e sotëm Laçi.<sup>18</sup> Duke u bazuar mbi onomastikën,<sup>19</sup> nisur nga mbiemri i familjes që quhej në fillim Laçi-Albani, kërkimet u fokusuan në zonat ku ekzistonte toponimi dhe antroponimi i familjes me këtë mbiemër: në Laçin e Kurbinin, Laçin e Zadrimës dhe Bregun e Laçit ose asokohe Laçin e Krasniqes në Malësinë e Gjakovës (Tropojë) si dhe në Kosovë, ndërsa Kepi i Laçit pranë Kavajës ishte një port i pabanuar.

Kështu, konsulli venecian i Durrësit, Pietro Rosa, u njoftua nga prefekti i misionit françeskan në Shqipëri që të mblidhte të dhëna në Laçin e Kurbinin, Mark Kallamashi nga Zadrima që ishte prift në Kotorr në Laçin e Zadrimës të Lezhës dhe Antonio nga Montemuro e Nikolla Boscarisich në Bregun e Laçit të Krasniqes (Malësia e Gjakovës në Tropojë) dhe Kosovë.

Duke u mbështetur kryesisht mbi relacionet e famullitarit Mark Kallamashi (Kalimaçi) në Zadrimë dhe Antonio-s nga Montemuro në Shqipërinë e Veriut e në Kosovë, mësojmë se mbiemri ekzistonte në formën Laçi në Laçin e Zadrimës e Kalivaç të Lezhës dhe në Gjakovë.

Valentini përgatiti një pemë gjenealogjike të familjes Albani, që sipas relacioneve të përmbledhura mund ta ketë origjinën më tepër nga Laçi i Kurbinin që shtrihet ndërmjet Krujës, Lezhës e Durrësit, ndërsa Laçi i Zadrimës dhe Bregu i Laçit të Krasniqes bënin pjesë në dioqezën e Sapës dhe gjenden sipas tij në atë territor mesjetar që u përkiste Dukagjinëve.<sup>20</sup>

Sipas përshkrimit të Mariano Bolizza-s në çerekun e parë të shek. XVI, ekzistonte Laçi i Kurbinin, ose Laçi i vogël që kishte 100 shtëpi dhe

vol. II (Tiranë: Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 1963), dok. nr. 2, 49-206.

<sup>18</sup> Valentini, “Albani-Lazzi”, 139.

<sup>19</sup> *Onomastika merret me studimin e emrave të përveçëm të vendeve dhe njerëzve dhe ndahet në toponiminë dhe antroponiminë*, [http: www.wiki.shqipopedia.org](http://www.wiki.shqipopedia.org) (shikuar më 04.05.2023).

<sup>20</sup> Valentini, “Albani-Lazzi”, 140.

500 njerëz të aftë për të mbajtur armë dhe Laçi i Zadrimës ose Laçi i madh, i përbërë nga 300 shtëpi dhe 700 njerëz të aftë për të mbajtur armë si dhe Kepi i Laçit «il caput de Lachia», që ishte thjesht një port i braktisur që paraprinte Durrësin në pjesën jugore në drejtim të Kavajës.<sup>21</sup> Ndërsa në pjesën veriore gjendej Kepi i Rodonit dhe porti i Shufadës që njihej si bregdeti i Kastriotëve, pjesë e Arbërisë që nuk kontrollohej nga venecianët.<sup>22</sup> Në relacionin e konsullit venecian të Durrësit, Pietro Rosa, thuhet se në Laçin e Kurbinit në dekadat e para të shek. XVIII numri i shtëpive ishte reduktuar rreth 3-4 herë dhe kishin mbetur vetëm 30 shtëpi.

Konsulli Rosa, megjithëse nuk kishte gjetur të dhëna për pasardhës të familjes në Laç, kishte takuar më të moçmit e zonës të cilët mendonin se Gjergji dhe Filipi, që kishin qenë nën drejtimin e Skënderbeut «*memorable e mai lodato abbastanza*» ishin nga Laçi i Kurbinit dhe mbiemri e kishte prejardhjen nga lokaliteti dhe jo nga familja: «*Riferisce la costante opinione e tradizione di questi Paesani vecchi e piu' sensati che gli Albani Giorgio e Filippo di Michele da Lazzi, e che servissero Scanderbecho*». Gjithashtu, një fakt tjetër për t'u sqaruar ishte nëse ishin nisur në Itali para apo pas vdekjes së heroit kombëtar.

Riceputi pohon se gjatë qëndrimit në Romë me sa duket në vitin 1719 kishte takuar Papën Klementi XI, nga i cili i kishte ardhur një lajmërim «*comunicazione con notizie della famiglia*» që daton nga epoka e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, ku vihen në pah fitoret e tij gjatë Rrethimit të Parë dhe të Dytë të Krujës si dhe vdekja e papritur e Papës Enea Piccolomini Piu II, i cili do ta kishte kurorëzuar Skënderbeun, mbret të Arbërisë e do ta kishte ngritur Pal Engjëllin në rangun e kardinalit si dhe mënyrën e kalimit të familjes Laçi - Albani në Urbino. Nga dokumentet në Romë për familjen Albani, që Papa ia kishte kaluar Riceputit, arrijmë në përfundimin se familja Albani kishin lidhje farefisnore me Kastriotët dhe tre vëllezërit Gjergj, Filip dhe Gjon Lazi (Laçi). Bijtë e Mikel Lazit (Laçi) ishin tre nga princat e Gjergj Kastriotit, që e shoqëronin atë në Itali në vitin 1464 dhe gjatë kthimit ai i la me

<sup>21</sup> Biblioteca Kombëtare e Shqipërisë (më tej: BKSH), AnVA6, Mariano Bolizza, *Descrizione di Scuttari, Dolcigno et altri luoghi per Francesco Bolizza* (Venezia: 1614), 48, 50.

<sup>22</sup> Alain Ducellier, "Fronti detar i principatës së Kastrotëve prej fundit të shekullit XIV deri në vdekjen e Skënderbeut", në *Konferenca e dytë e Studimeve Albanologjike me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut (12-18 janar 1968)* (Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, 1968), 3.

mision diplomatik pranë dukës Federico të Montefeltros, në oborin e tij asokohe në Rimini, që u spostua më pas në Urbino.<sup>23</sup> Sigurisht, në këtë mes mund të flasim për aleanca, që ishin me shumë rëndësi për Skënderbeun, sepse me ndihmën e Mbretit Ferdinand të Napolit, Federiku mbante postin e kapitenit të përgjithshëm të ligës papnore të shteteve italiane dhe mund të ishte një pikë mbështetjeje në vitet e fundit të sfidës së tij me turqit.

Paraardhësi i familjes ishte Mikel Lazi (Laçi), i cili, sipas Visconti-t, rridhte nga një familje shqiptare.<sup>24</sup> Në gjenealogjinë e tij, ndryshe nga të tjerët, ai pohon se Mikeli, babai i tyre duhet të ketë ardhur i pari në Itali dhe më pas Gjergji, djali i tij dhe paraardhësi i linjës së Klementit XI të ketë qëndruar pranë Roberto Malatesta-s së Riminit dhe më pas të Francesco Maria I e Guidobaldo II della Rovere.<sup>25</sup> Ndërsa për vëllain e tij, Filipin, thotë se ai u shqua edhe më tepër me Malatestat dhe kryesisht me Giovanni Malatesta-n më 1494, dhe më pas u largua në Republikën e Venecies e vdiq në Ravenë në vitin 1508.<sup>26</sup>

Pikërisht njëri prej vëllezërve Gjergji, që ishte paraardhësi i Papës Klementi XI, qëndroi në Urbino dhe ky degëzim i familjes i dha Selisë së Shenjtë një papë dhe tre nipër të tij kardinalë.

Në relacionet nga Shqipëria dhe Kosova, flitet gjithashtu për lidhje farefisnore me familjen e rëndësishme Bruti të Durrësit, nga e cila rrjedhin në shekujt në vijim dragomanët e Venecies me Perandorinë Osmane. Kështu, nga pjesëtarë të kësaj familjeje në Kapodistria (Koper), duke u bazuar në pemën e familjes, flitet për një lidhje të trefishtë ndërmjet familjes Bruti të Durrësit, Kastriotëve dhe familjes Laçi. Në një relacion tjetër të Nikola Boscarisić-it (Nikolla Boscarisiq) nga Kosova thuhet se familja Laçi e kishte prejardhjen nga familja Kopiliq, që mendohet të ketë qenë me origjinë shqiptare, nga e cila rridhte heroi i Betejës së Kosovës të vitit 1389, Miloš Kobilić (Millosh Kopiliq), i cili

<sup>23</sup> Eqrem Zenelaj, *Gjenealogjia e familjes shqiptare Albani nga Urbino dhe Bergamo e Italisë – Papës Clementi XI Albani* (Prishtinë: Konica, 2009), 175. Origjina shqiptare e familjes dëshkohet në pemën gjenealogjike që autori ka botuar në shtojcën e librit të J. W. Imhof, *Albanensis genealogia familiae*, ku rezulton edhe vëllai i tretë, Gjoni.

<sup>24</sup> Pietro Ercole Visconti, *Città e famiglie nobili e celebri dello Stato pontificio, Dizionario storico del commendatore Pietro Ercole Visconti. Storia di Roma, famiglie nobili*, vol. III (Roma: Tipografia delle scienze, 1848), 3.

<sup>25</sup> *Po aty*, 4-5.

<sup>26</sup> *Po aty*.

ishite gjithashtu dhëndri i Mbretit të Serbisë, Lazarović.<sup>27</sup> Nisur nga pema e familjes Bruti-Bruni-Boriçi, Antonio I Bruti ishte martuar me Oria Kastriotin në vitin 1446 dhe djali i tyre Barnaba Bruti kishte një lidhje martesore me Gioia Capelichio-n (Kopiliqin) më 1474, që nuk dihet nëse është e njëjta familje.<sup>28</sup> Madje, autori i relacionit mendon se mbiemri Kopiliq e ka formën në italisht *Capolichio* ose *Capo-lichio*, që të ndara do të thotë kreu i Laçit. Ekziston edhe kjo hipotezë sado që nuk e dimë nëse është e vërtetë, apo me veshjen e mitit.

Atë Mark Kallamashi, prift françeskan në Kotorr, ishte ngarkuar për të bërë kërkime për prejardhjen e familjes Albani sepse ishte nga Kalivaçi i Lezhës, fshat në afërsi të Laçit të Zadrimës në dioqezën e Sapës dhe kishte shërbyer edhe në Laçin e Kurbinit. Megjithatë, në relacionin e tij të gushtit të vitit 1720, ai gabohet kur pohon se, sipas tij, të dyja lokalitetet ishin nën juridiksionin e Durrësit që përfshinte vetëm zonën deri në lumin e Matit, ndërsa fshatrat përtej tij bënin pjesë në zonën e Lezhës. Në fakt, për të përcaktuar vendndodhjen ai i referohet hartës së Giacomo Cantelli da Vignola-s, sipas të cilit Laçi i Zadrimës përkon me *Lagi Conti*-n që ishte vendi nga vinte familja, sado që ekzistonte edhe Laçi dhe duhej të ishte 50 milje larg Durrësit dhe 6 milje larg lumit Drin, si dhe 28 milje larg bregdetit. Familja Laçi-Albani ashtu si Kastriotët dhe Balshajt ishin princa të Misjes, zonë që shtrihej ndërmjet Krujës, Kepit të Rodonit dhe Lezhës.<sup>29</sup> Ai pohon në një dëshmi të tij të drejtpërdrejtë që iu dha Filippo Riceputi-t, të cilit iu duk e saktë dhe plotësisht e mundur se familja Albani e quajtur Laçi ishin nga fusha e «Laçit pranë Kalivaçit».

Së fundi, frati Antonio nga Montemuro, sipas Vinçenc Zmajeviqit ishte dërguar në zonën e Kelmendit, por pas largimit të kelmendasve drejt

---

<sup>27</sup> Noel Malcolm, *Kosova: një histori e shkurtër*, përkth. A. Karjagdiu (Prishtinë: Koha, 1998), 105-106; Anna Di Lellio, "Introduction", *The Battle of Kosovo 1389: an Albanian epic*, përkth. Robert Elsie (London, New York: I. B. Tauris: Centre for Albanian Studies, 2009), 3-4, 25-26.

<sup>28</sup> Cristian Luca, *Dacoromano-Italica. Studi e ricerche sui rapporti italo-romeni nei secoli* (Cluj-Napoca: Accademia Romana, Centro di Studi Transilvani, 2008), 105-128. Albero genealogico nr. 5 della famiglia Bruti; Noel Malcolm, *Agjentë perandorakë: një familje shqiptare në botën mesdhetare të shekullit të gjashtëmbëdhjetë*, përkth. Kastriot Myftiu (Tiranë: Dudaj, 2016), 24.

<sup>29</sup> Milan Šufflaj, *Serbët dhe Shqiptarët* (Tiranë: Bargjini, 2002), 114.

Peshterit,<sup>30</sup> u largua bashkë me ta dhe ishte ftuar që ta përgatiste relacionin nga Jeronim Bukja (Buća - Girolamo Bucchia), kolonel i Venecies me origjinë shqiptare nga Kotorri. Në vitin 1716, ai ishte takuar me ipeshkvin e prelatin Giuseppe di Pedano, misionar apostolik, që i komunikoi se kishte pasur kontakte me vetë Papën Klementi XI «*i ishte kërkuar me këmbëngulje me gojën e tij nga Shkëlqesia e tij në Selinë e Shenjtë Klementi XI, që me zell të informohej mundësisht saktë për vendin e pasardhësve të quajtur Laçi, të cilit ia rekomandoj këtë fakt si njerëz që i njohin anët e Maqedonisë, Shqipërisë dhe Serbisë.*»<sup>31</sup>

Ai takon në Kosovë një plak të moçëm 107-vjeçar Gjeç Gjoka, banor i Junikut, që kishte marrë pjesë në përballjen e Kelmendit me Vuço Pashën në vitin 1636, i cili i përgjigjet për praninë e degëve të familjes në Kosovë të Ali Laçit në Gorozhupë dhe kështjellarit Ahmet Laçi në Nebregosthtë të Prizrenit. Madje, Gjeçi paraqet edhe dëshminë e Kolë Vatës, një plak 100-vjeçar, që e kishte takuar në moshën 70-vjeçare, i cili pohonte se dikur kishte pasur paraardhës të familjes në Bregun e Laçit të Krasniqes dhe se disa degë të familjes ishin larguar drejt qyteteve të Arbërisë Qendrore dhe përtej detit. Për më tepër, ai shton se kjo degë e familjes mbante poste të larta në Kosovë ashtu si degëzimi hipotetik që kishte emigruar.

Si përfundim, mund të themi se, mbiemri i familjes rrjedh nga toponimi Laçi që e ka prejardhjen nga Laçi i Kurbinit ose Laçi i Zadrimës së Lezhës, por ekziston hipoteza e një lëvizjeje të familjes nga zona verilindore dhe Kosova drejt Arbërisë Qendrore dhe të emigrimit në Itali në vitin 1464 dhe ndarjes së familjes sipas Valentinit në tri degë: 1. Gjergj Laçi i martuar me Lucrezian dhe djali i tyre Altobello Albani i Urbinit; 2. Filip Laçit në Venecia e Ravenë; dhe 3. vëllezërit Ahmet e Ali Laçi të pranishëm në Kosovë në vitin 1720.<sup>32</sup>

<sup>30</sup> Vincenzo Zmajevich, *Relacion i gjendjes së Shqipërisë e Serbisë – Relazione dello Stato d'Albania e Serbia (1702-1703)*, ed. Albert Ramaj, Peter Bartl, Injac Zamputti (St. Gallen: Albanisches Institut, Prishtinë: Faik Konica, 2022), 52, 159, 212. Sipas Bartl-it, Peshtera ndodhet ndërmjet Limit, Ibrit të Epërm, Novi Pazarit dhe Sjenicës.

<sup>31</sup> BMC, ms. cod. cic. 3222/V, Filippo Riceputi, *Prospectus Illirici Sacri*. «*d'haver havuto caldissima incombenza della propria bocca di sua M.tà Regnante Clemente XI, di dover fare esatta diligenza et informarsi al possibile del luogo della stirpe detto Lazi, il che raccomandò a me tal fatto come a pratico delle parti della Macedonia, Albania e Servia*»<sup>31</sup>.

<sup>32</sup> Valentini, “Albani-Lazzi”, 144.

**Bibliografi:****Botime dokumentare:**

*Relazione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të Mesme në shek. XVII, Burime e materiale (1634-1650)*. Përktheu dhe përgatiti për botim Injac Zamputi, vol. II. Tiranë: Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1963.

**Literaturë historiografike:**

Andreato, Stefano. "Papa Clemente XI", *Dizionario Bibliografico degli Italiani*. Roma: Istituto dell'Enciclopedia Italiana Treccani, 1982, vol. XXVI.

Riceputi, Filippo. *Prospectus Illirici Sacri*. Biblioteca del Museo Correr (BMC), manoscritto codice Cicogna (ms. cod. cic.) 3222/V.

Bolizza, Mariano. *Descrizione di Scuttari, Dolcigno et altri luoghi per Francesco Bolizza*. Venezia: 1614. Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë (BKSH), AnVA6.

Ahmeti, Musa & Etleva Lala. *Illyricum Sacrum, botime dhe dokumenta*. Tiranë: Ombra GVG, 2007.

Di Lellio, Anna. *The Battle of Kosovo 1389: an Albanian epic*, përkthyer nga Robert Elsie. London, New York: I. B. Tauris, Centre for Albanian Studies, 2009.

Ducellier, Alain. "Fronti detar i principatës së Kastrotëve prej fundit të shekullit XIV deri në vdekjen e Skënderbeut", në *Konferenca e dytë e Studimeve Albanologjike me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut (12-18 janar 1968)*. Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, 1968.

Luca, Cristian. *Dacoromano-Italica. Studi e ricerche sui rapporti italo-romeni nei secoli*. Cluj-Napoca: Accademia Romana, Centro di Studi Transilvani, 2008.

Lucich, Stefan Paulovich. "Cenni intorno all'autore Filippo Riceputi". In *Memorie di cose dalmatiche nella storia della vita di San Giovanni Orsini vescovo di Trau scritta da padre Riceputi*. Zara: Tipografia Demarchi-Rougier, 1864.

Malcolm, Noel. *Kosova: një histori e shkurtër*. Përkthyer nga A. Karjagdiu. Prishtinë: Koha, 1998.

Malcolm, Noel. *Agjentë perandorakë: një familje shqiptare në botën mesdhetare të shekullit të gjashtëmbëdhjetë*. Përkthyer nga Kastriot Myftiu. Tiranë: Duda, 2016.

- Riceputi, Filippo. *Prospectus Illyrici Sacri cujus historiam describendam, typisque mandandam suscipit P. Philippus Riceputi Societatis Jesu sacerdos*. Patavii: Excudebat Josephus Cominus, 1720.
- Šufflaj, Milan. *Serbët dhe Shqiptarët*. Tiranë: Bargjini, 2002.
- Saraçi, Alvin. “Feja dhe Atdheu në Kuvendin e Arbrit: Roli i Papë Klementit XI, Propagandës Fide dhe Vinçenc Zmajeviqit”. Në *Studime historike*, 3-4, 2022.
- Saraçi, Alvin. “Le origini albanesi di un Papa: Clemente XI Albani”. In *Notiziario dell'Associazione Nobiliare Regionale Veneta*, Nuova Serie, anno II, 2, 2010.
- Saraçi, Alvin. “Relazioni di missionari cattolici sull’origine albanese del Papa Clemente XI Albani”. In *Notiziario dell'associazione nobiliare regionale veneta*, anno IV, 4, 2012.
- Valentini, Giuseppe. “Albani-Lazzi”, *Leka*, viti XV, nr. 2, 1943.
- Vanino, Miroslav. «Philipp Riceputi S.I. Begründer des “Illyricum sacrum”». In *Archivum historicum Societatis Iesu*, I, Roma, 1932.
- Visconti, Pietro Ercole. *Città e famiglie nobili e celebri dello Stato pontificio, Dizionario storico del commendatore Pietro Ercole Visconti. Storia di Roma, famiglie nobili*, vol. III. Roma: Tipografia delle scienze, 1848.
- Zenelaj, Eqrem. *Gjenealogjia e familjes shqiptare Albani nga Urbino dhe Bergamo e Italisë – Papës Clementi XI Albani*. Prishtinë: Konica, 2009.
- Zmajevich, Vincenzo. *Relacion i gjendjes së Shqipërisë e Serbisë – Relazione dello Stato d'Albania e Serbia (1702-1703)*. Redaktuar nga Albert Ramaj, Peter Bartl, Injac Zamputti. St. Gallen: Albanisches Institut, Prishtinë: Faik Konica, 2022.

### ALVIN SARAÇI

Institute of History/ Academy of Sciences of Albania

saracialvin@hotmail.com

<https://doi.org/10.61773/6j79fd64>

### S u m m a r y

#### THE ALBANIAN ORIGIN OF THE POPE CLEMENT XI ALBANI

The article deals with the Albanian origin of the Pope Gianfrancesco Albani Klementi XI (1700-1721), who interested as he was about his lineage, charged with the task the jezuit Filippo Riceputi together with the Albanian

---

from Zadar Paçifik Bici in 1720 to undertake a trip in Albania in order to collect reports that cast light on the family Albani, whose last name originally was Laçi. The research concentrated in the areas where the family originated: Laçi of Kurbini, Laçi of Zadrime, Laçi of Krasniqe in Tropoja and Kossovo. Referring to the reports, the origin of the family must have been from Laçi of Kurbini, but it is likely that it comes from the nearby area of Laçi of Zadrime. The presence of the Laçe family in Kossova make a hypothesis that the family may have moved from Northeast to the central Albania and then it migrated to Italy.